BalkanWeb | GAZETA SHQIPTARE

EMRI/ Tentoi të trafikonte armë në Shqipëri, arrestohet në Morinë 26-vjeçari, ja çfarë ïshte i gjetur në banesë

28 Gusht, 2025 00:31

Madhësia e tekstit:

Një 26-vjeçar ka rënë në prangat e policisë pasi tentoi të trafikonte armë.

26-vjeçari me inicialet Ilirjan Skacaj, u kap gjatë kontrolleve në Morinë, pasi tentoi të fuste në Shqipëri dy armë zjarri pistoleta.

Ndërsa gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi, në Shkodër, Policia gjeti një tjetër armë zjarri, municion luftarak, sasi dhe fara të cannabis sativës.

NJOFTIMI:

PKK Morinë/Kontrolle të shtuara, me përzgjedhje, bazuar në inteligjencën policore, me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimeve kufitare.

Finalizohet operacioni policor i koduar "Transcendence", i zhvilluar nga Policia Kufitare e Morinës, në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Parandalohet dhe goditet një rast i tentativës për të trafikuar armë zjarri, nga Kosova, drejt vendit tonë.

Vihet në pranga një 26-vjeçar që tentoi të fuste në Shqipëri, 2 armë zjarri pistoleta.

Në vijim, gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi, në Shkodër, Policia gjeti një tjetër armë zjarri, municion luftarak, sasi dhe fara të cannabis sativës.

Sekuestrohen 3 armët e zjarrit pistoleta, fishekë luftarak, një sasi lënde narkotike cannabis sativa, 400 fara të cannabisit dhe 2 targa.

Si rezultat i intensifikimit të kontrolleve me përzgjedhje, për shkak të fluksit të qytetarëve në hyrje/dalje, me qëllim parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme dhe krimeve të tjera kufitare, shërbimet e Policisë Kufitare të Morinës kanë finalizuar operacioninn policor të koduar "Transcendence", si rezultat i të cilit u parandalua dhe u godit një tjetër rast i tentativës për të trafikuar armë zjarri, nga Kosova, drejt Shqipërisë.

Në kuadër të këtij operacioni, është kapur në flagrancë dhe është arrestuar nga specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve të DVP Kukës, shtetasi I. S., 26 vjeç, banues në Shkodër.

Gjatë kontrollit në vijë të dytë, në hyrje të RSh–së, 26-vjeçarit i janë gjetur me vete dhe në çantë, 2 armë zjarri pistoleta, të cilat dyshohet se do të trafikoheshin në vendin tonë.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, është koordinuar me Policinë e Shkodrës, ku është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit I. S., në Shkodër, ku janë gjetur një tjetër armë zjarri pistoletë, fishekë luftarak, një sasi lënde e dyshuar narkotike cannabis sativa, 400 fara të dyshuara të kësaj bime dhe 2 targa automjeti, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me 2 pisoletat që iu gjetën shtetasit I. S., në PKK Morinë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikosë: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arme zjarri · Morinë · policia

TË NGJASHME

Përplasai kamionçorin në Durrës, 50-vjeçari ndërroi jetë në spital, arrestohet 19-vjeçari
28 Gusht, 2025

Fluksi i kalimeve në kufi, ministri Balla takim me strukturat e Policisë në Han të Hotit: Sezoni s'ka mbarsur, rritet gatishmëria!
28 Gusht, 2025

Taboola Feed

Why Do Women Wear This Dress All The Time?
Miller | Sponsored
Learn More

Fier Surgeon: Easy Method Relieves Tinnitus (Ear Ringing)
Health Benefits | Sponsored

Video/ Sherr mes vajzave në Vlorë, shihni skandalin që ndodh në mes të lokalit
Video/ Sherr mes vajzave në Vlorë, shihni skandalin që ndodh në mes të lokalit
balkanweb.com


This mineral will melt your belly fat fast
well-being-review-DietDrops | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Anëtar i një bande kriminale/ Aterrati 32-vjeçarë shqiptar në Athinë, plagoset edhe e reja greke. Dëshmia e vajzës: Nuk njihesha
28 Gusht, 2025

EMRAT/ Aksident në aksin Sarandë-Gjirokastër, makina përplaset me motorin, plagosen dy turistët italianë
28 Gusht, 2025

"Aqua të pastra" i shpallur në kërkim pas kultivimin e kanabisit, arrestohet 33-vjeçari (EMRI)
28 Gusht, 2025

Ia bë atentat në Athinë, ja kush është i ri shqiptar që mbeti i plagosur (EMRI)
28 Gusht, 2025

Shohen të gjitha vatrat e zjarrit në vend, ministri Peleshi: Situata në grumbullimin e gjahrave në Elbasan, në monitorim
28 Gusht, 2025

Armë, drogë e municion luftarak në automjet dhe në banesë, arrestohet 41-vjeçari në Tiranë, policia jep detajet
28 Gusht, 2025

KATEGORIA VIDEO

E pëlqtë/ "Nuk e marr personalë, por vëllo vepreja si Mitsotakis", flama për 'Kathimerini': Ja si do veprojnë me Fredi Beleriri! Nëse nuk betohet...
28 Gusht, 2025

"Nesër fillon regjistrimi", dekani i Fakultetit të Ekonomisë-mësuesimi: Pedagëgëmve do të jenë specialistë të kërkuar në tregun shqiptar
28 Gusht, 2025

FOTO/ 7 gola për 3 pikë, "çmendurí" në Villarreal-Barça, Xavi dhe Spanja ndërkohë: Lamine Yamal Éshtë një yll
28 Gusht, 2025

BE: Do monitorojmë fëmijët e Portos Romanos me njëtin TENT, 62 mln euro të ndikuara dëm në Portin e Durrësit
28 Gusht, 2025

FOTO/ "Nunez heaht Newcastle", sukseni Klopp "pushton" mediat. Guardiola vendos rekord
28 Gusht, 2025

Video/ Punëje unike dhe e rrallë, elefanti lufton me krokodilin e urtur në lumë
28 Gusht, 2025

Kërko kritu

LËJMET E FUNDIT

Basha homazhe për ish-Prefektin e Tiranës, Gazim Muhedi: Historia duhet të trashëgohet me objektivitet
28 Gusht, 2025

Politico: Udekja e Prigozin vetëm e forcon Putinin për të ardhmen e afërt, ndërsa... Zyrtarët amerikanë dhe evropianë analizojnë situatën në Rusi
28 Gusht, 2025

E pëlqtë/ "Nuk e marr personalë, por vëllo vepreja si Mitsotakis", flama për 'Kathimerini': Ja si do veprojnë me Fredi Beleriri! Nëse nuk betohet...
28 Gusht, 2025

Checco Zalone shijon Shqipërinë: Pushova në Green Coast por do rikthehem si vizitor në Vlorë nga ku mund të ikësha ide për një film të ri
28 Gusht, 2025

Anëtar i një bande kriminale/ Aterrati 32-vjeçarë shqiptar në Athinë, plagoset edhe e reja greke. Dëshmia e vajzës: Nuk njihesha
28 Gusht, 2025

EMRAT/ Aksident në aksin Sarandë-Gjirokastër, makina përplaset me motorin, plagosen dy turistët italianë
28 Gusht, 2025

NA NDIGNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2025 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.